



Pranuar më: Primlajeno:	15.07.2021	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
07-016	39243	



Komuna e Lipjanit

I. Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson drejtori **z. Mahmoud Abbas Shaker**, tutje referuar si **pala e parë**, dhe:

II. Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës, **z. Imri Ahmeti**, tutje referuar si **pala e dytë**,

Më datë 09/07/2021, lidhin këtë :

Memorandum Bashkëpunimi Për hapjen e puseve për ujë të pijes

Neni 1

Objekti i Memorandumit

Objekt i Memorandumit të Bashkëpunimit është hapja e tridhjetë (30) puseve për ujë të pijes, në vende të ndryshme publike për familjet në kushte të rënda ekonomike në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Obligimet e palës së parë

Pala e parë nënshkruese, merr përsipër të gjitha shpenzimet e realizimit të këtij projekti, ku përfshihen: hapja e puseve në thellësi të ndryshme (sipas nevojës), si dhe montimi i pompave të ujit me pajisjet përcjellëse dhe vendosja e rubinetës së bashku me shenjën identifikuese të donatorit të projektit.

Neni 3

Obligimet e palës së dytë

Pala e dytë nënshkruese, merr përsipër sigurimin e listave me përfituesit e propozuar, në pajtueshmëri me rregulloren e Republikës së Kosovës, duke i përmbushur kriteret kryesore për secilën familje si në vijim:

- 1) Kushtet e rënda ekonomike;
- 2) Mundësia e hapjes së pusit, daljes së ujit, cilësisë së ujit; dhe
- 3) Përfituesi potencial - nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale.

Neni 4

Obligimet e ndërsjella

Kontaktet mes dy palëve dhe procedurat deri në kohën e nënshkrimit të këtij memorandumit konsiderohen plotësuese të të njëjtit. Procedurat e obligueshme janë si në vijim:

- Realizimi i vizitave tek përfituesit e propozuar nga të dyja palët (përfaqësuesi i organizatës dhe përfaqësuesit e Komunës);
- Përzgjedhja e përfituesve prej të dyja palëve në pajtim me Rregulloren e "QATAR CHARITY" me të cilën përcaktohen kushtet për përzgjedhjen e përfituesve si dhe në koordinim me Komunën; dhe
- Në rast të dështimit të hapjes së ndonjë pusit, projekti vazhdon me rastet të cilat janë në listën rezervë të pritjes duke filluar nga ato me numër më të madh të pikëve. Në rast të mos ekzistimit të rasteve nga lista rezervë, palët pajtohen që të vazhdojnë zbatimin e projektit vetëm për numrin e mundshëm të realizuar.

Neni 5

Afati i përmbushjes

Palët nënshkruese pajtohen që pranimi teknik të realizohet prej dy palëve dhe finalizimi i projektit do të bëhet më së largu deri më datën 31/12/2021.

Komuna e Lipjanit

Neni 6

Të drejtat e ndërsjella

Të dy palët mbajnë të drejtën e inspektimit-vizitës pa paralajmërim të përfituesit, fotografimin apo zhvillimin e intervistës me përfituesin, me qëllim që të binden për arritjen e qëllimit/realizimit të projektit.

Neni 7

Të përgjithshme

Rregullat e përgjithshme që Rregullojnë bashkëpunimin e Qatar Charity me të gjitha palët gjatë zbatimit të projekteve të saj, janë:

- (i) Respektimi i të drejtave të fëmijës, mbrojtja e grupeve të marginalizuara dhe parandalimi i shkeljes së të drejtave të tyre;
- (ii) Respektimi i parimit të transparencës dhe rregullave të anti-korrupsionit dhe nepotizmit;
- (iii) Respektimi i rregullave të mbrojtjes së mjedisit në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare;
- (iv) Ndërprerja e çdo marrëdhënieje kontraktuale me palën kontraktuese, nëse mëson drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë (nëpërmjet bazës së të dhënave World Check) se kontraktuesi është dënuar më parë për një vepër penale, apo se është akuzuar për pastrim të parave apo financim të terrorizmit, në përputhje me ligjet në fuqi;
- (v) Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me ndalimin e pastrimit të parave dhe ndalimin e financimit të terrorizmit.

Neni 8

Zgjidhja e paqartësive

Palët nënshkruese pajtohen që në rast të ndonjë paqartësie eventuale në mes palëve nënshkruese sa i përket realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi, zgjidhja të bëhet me mirëbesim dhe biseda të ndërsjella mes tyre.


Neni 9

Ky memorandum është i lidhur në dy (2) kopje identike, prej të cilëve secila palë mbanë nga një (1) kopje.

Nënshkruajnë:

Për "Qatar Charity"

z. Mahmoud Abbas Shaker, Drejtor



(nënshkrimi)

قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

Për Komunën e Lipjanit:

z. Imri Ahmeti, Kryetar



(nënshkrimi)



REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
REPUBLICA KOSOVO